



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

---

---

#### NJOFTIM PER MEDIA

Referuar interesimit të medias, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, informon sa më poshtë:

Në kuadër të marrjes dhe zbatimit të masave për personat të cilët janë të shpallur në kërkim nga organet e drejtësisë, për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, Shërbimet e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit kanë marrë informacion në rrugë operative se, në banesat e personave nën hetim **A (A) alias S. K**, dhe **J.K** strehohet shtetasi me initiale **A.B**, person ndaj të cilit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka caktuar masën e sigurimit me karakter shtrëngues personal “arrest në burg”, pasi dyshohet për kryerjen e veprave penale “Vrasje me paramendim”, e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje e armëve, armëve luftarake dhe municionit”.

Mbi kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është zhvilluar gjykimi lidhur me vlerësimin si të ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj:

- (I) personit nën hetim me initiale **A (A) alias S. K**, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”, “*Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive*” dhe “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë penale*”, parashikuar nga nenet 278/3 dhe 4, 280, si dhe 287/1 të Kodit Penal.
- (II) personit nën hetim me initiale **J.K**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Përkrahja e autorit të krimit*”, parashikuar nga neni 302/1 i Kodit Penal.

**I.** Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, me vendimin nr. 349, datë 29.08.2024, ka vendosur:

- Vlerësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë datë 28.08.2024, ndaj personit nën hetim **A (A) alias S. K.**, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë penale”, parashikuar nga nenet 278/3 dhe 4, 280, si dhe 287/1 të Kodit Penal.

- Caktimin ndaj personit nën hetim **A (A) alias S. K.**, masën e sigurimit personal shtrëngues atë të “arrestit në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

*Çështja në apel u shqyrtua mbi bazën e ankimit të bërë, nga personi nën hetim me iniciale A (A) alias S. K., i cili kërkoi ndryshimin e vendimit, deklarin e paligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit më të butë se “arresti në burg”.*

**II. Gjykata e Shkallës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, me vendimin nr. 348, datë 29.08.2024, ka vendosur:**

- Vlerësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë datë 28.08.2024, ndaj personit nën hetim **J.K.**, i dyshuar për kryerjen e vepraës penale “Përkrahja e autorit të krimit”, parashikuar nga neni 302/1 i Kodit Penal.

- Caktimin ndaj personit nën hetim **J.K.** masën e sigurimit personal shtrëngues atë të “arrestit në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

*Çështja në apel u shqyrtua mbi bazën e ankimit të bërë, nga personi nën hetim me iniciale J.K. i cili kërkoi ndryshimin pjesërisht të vendimit, caktimin e një mase sigurimi më të butë se ajo e “arresti në burg”.*

**Në përfundim të gjykimit, më datë 04.10.2024, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e përbërë nga Gjyqtare znj. Arta Duka, vendosi:**

1. Miratimin e vendimit nr. 349, datë 29.08.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.
2. Miratimin e vendimit nr. 348, datë 29.08.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

**Tiranë, më 04.10.2024**

**GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**